

## LIGJ Nr. 55/2023

### PËR MENAXHIMIN E GARANCIVE DHE KREDIVE SHTETËRORE TË PAKTHYERA

Në mbështetje të neneve 78, 81, pika 1, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:  
KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

#### Objekti i ligjit

Ky ligj ka për objekt përcaktimin e rregullave për menaxhimin dhe kthimin e garancive shtetërore të huas, si dhe kthimin e kredive shtetërore të pakthyera, të dhëna nga bankat e nivelit të dytë, me kapital tërësisht shtetëror para privatizimit të tyre.

Neni 2

#### Përkufizimet

1. Termat e përdorur në këtë ligj kanë kuptimin si më poshtë:

a) “Debitorët e bankës” do të vlerësohen si debitorë të Agjencisë së Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyera për të gjitha kreditë e transferuara prej saj, sipas këtij ligji. Agjencia e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyera gëzon të drejtat që banka ka pasur mbi debitorin, duke përfshirë edhe ndryshimet që banka mund t’i ketë bërë me marrëveshje ndërmjet debitorit dhe asaj përpara datës kur kredia është transferuar në pronësi të Agjencisë;

b) “Garanci shtetërore”, “nënhua dhe nënhuazim” dhe “skema të veçanta të garancive” kanë të njëjtin kuptim si në legjislacionin në fuqi për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë;

c) “Kthimi i garancive, huave dhe nënhuave” është procesi i mbledhjes së detyrimeve të huamarrësve kundrejt ministrisë përgjegjëse për financat për detyrimet që kanë lindur si rezultat i pagesës së garancive nga ministria përgjegjëse për financat dhe si rezultat i marrëdhënies së huadhënies dhe nënhuazimit të fondeve, duke ezauruar rrugën gjyqësore dhe përmbarimore deri në likuidimin total të detyrimeve, proces i cili do t’u nënshtrohet rregullimeve të këtij ligji, pasi të jenë përmbushur parashikimet e marrëveshjeve specifike të garancisë;

ç) “Menaxhimi i garancive” është procesi administrativ që ka të bëjë me verifikimin e kushteve dhe kritereve të huamarrjes së institucioneve financiare në zbatim të skemave të veçanta të garancive, të miratuara nga Këshilli i Ministrave dhe të emetuara nga ministria përgjegjëse për financat, konfirmimin për draftin e marrëveshjes së huas, vijimin e procedurave të nënshkrimit të kredisë, verifikimin e rasteve të pagesës së garancisë dhe administrimin e të dhënave të skemave të veçanta të garancive;

d) “Ministër” është ministri përgjegjës për financat;

dh) “Trajtimi i kredive” është procesi i kthimit të kredive të pakthyera, të dhëna nga bankat e nivelit të dytë, me kapital tërësisht shtetëror para privatizimit të tyre, duke ezauruar rrugën gjyqësore dhe përmbarimore deri në likuidimin total të detyrimeve;

e) “Trajtimi i portofolit të investimeve” është procesi i kthimit të detyrimeve të pakthyerë të dhënanga shoqëria INSIG sh.a., në kohën kur kapitali i saj ka qenë në zotërim të shtetit, si kredi për blerjen e banesave, duke ezauruar rrugën gjyqësore dhe përmbartimore, deri në likuidimin total të detyrimeve;

ë) “Huamarrës” ka të njëjtin kuptim si kredimarrës në përputhje me legjislacionin në fuqi “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, si dhe Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë.

## KREU II

### AGJENCIA E MENAXHIMIT TË GARANCIVE DHE KREDIVE TË PAKTHYERA

#### Neni 3

#### **Agjencia e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyerë**

1. Agjencia e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyerë (në vijim “Agjencia”) është person juridik publik, buxhetor, në varësi të ministrit përgjegjës për financat, me seli në Tiranë.

2. Të ardhurat e përfituara sipas shkronjave “b” dhe “c” të pikës 1 të nenit 4 dhe nenit 15 të këtij ligji derdhen në buxhetin e shtetit. Këto të ardhura derdhen në buxhetin e shtetit brenda 30 (tridhjetë) ditëve.

3. Organizimi dhe funksionimi i Agjencisë përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

#### Neni 4 **Funksionet e Agjencisë**

1. Agjencia ka si funksion:

a) menaxhimin e skemave të veçanta të garancive të huas;

b) kthimin e garancive shtetërore të huas;

c) kthimin e huave dhe nënhuave të garantuara nga ministri përgjegjës për financat;

ç) verifikimin e aftësisë paguese të subjekteve huamarrëse për të cilat është kryer pagesa e garancisë në secilën prej skemave të garancive të miratuara, huave dhe nënhuave, të garantuara nga ministri përgjegjës për financat;

d) trajtimin e kredive të transferuara nga bankat tregtare të nivelit të dytë me kapital tërësisht shtetëror pas privatizimit të tyre; dh) trajtimin e portofolit të investimeve të kryera në banesa nga shoqëria INSIG sh.a., para privatizimit të saj.

2. Agjencia ushtron veprimtarinë e saj sipas neneve 499–507 të Kodit Civil, neneve 510, 511, 609, 610 të Kodit të Procedurës Civile, legjislacionit në fuqi për falimentimin dhe barrët siguroese, si dhe këtij ligji.

#### Neni 5

#### **Drejtori i përgjithshëm**

1. Agjencia përfaqësohet nga drejtori i përgjithshëm. Drejtori emërohet me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e ministrit.

2. Drejtori i Përgjithshëm duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;

b) të zotërojë diplomë të nivelit “Master i shkencave” apo të barasvlershme me të, të përfituar në fund të studimeve të ciklit të dytë me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 (dy) vjet akademike në

“Shkenca juridike ose ekonomike”. Edhe diploma e nivelit “Bachelor” duhet të jetë në të njëjtën fushë;

c) të ketë të paktën 5 (pesë) vjet përvojë në profesion si jurist ose ekonomist;

ç) të mos jetë i angazhuar në funksione drejtuese partiake të paktën 10 (dhjetë) vjetët e fundit para emërimit;

d) ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga puna, që nuk është shuar sipaslegjislacionit në fuqi;

dh) të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;

e) të mos ketë konflikt interesi me detyrën në përputhje me legjislacionin e konfliktit të interesave.

3. Drejtori i Përgjithshëm lirohet nga detyra kur:

a) plotësohet mosha për pensionin e plotë të pleqërisë;

b) dënohet me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e njëkundërvajtjeje penale me dashje;

c) deklarohet i paaftë për punë nga komisioni kompetent mjekësor;

ç) gjendet në një situatë të konfliktit të vazhdueshëm të interesit;

d) jep dorëheqjen nga detyra.

4. Drejtori i Përgjithshëm shkarkohet nga detyra kur:

a) konstatohen shkelje të dispozitave të legjislacionit në fuqi për të cilat ushtron veprimtarinë Agjencia;

b) kryen veprimtari që krijon konflikt interesash;

c) kryen shkelje të rënda gjatë kryerjes së detyrës;

ç) nuk realizon objektivat e vendosur nga Agjencia.

### KREU III

#### MENAXHIMI I SKEMAVE TË VEÇANTA TË GARANCIVE SHTETËRORE

##### Neni 6

#### **Verifikimi i përmbushjes së kërkesave të marrëveshjeve të garancisë në tipat e kontratave bankare dhe konfirmimi i këtyre kontratave tip**

1. Pas nënshkrimit të marrëveshjes së garancisë sipas legjislacionit në fuqi për borxhin shtetëror, institucionet financiare të përfshira në këto skema dërgojnë kërkesë pranë Agjencisë për konfirmimin e tipave të kontratave të kredive bankare, që do të përdoren në këto raste.

2. Agjencia kthen përgjigje brenda 10 (dhjetë) ditëve pune nga paraqitja e kërkesës nga institucionin financiar, duke verifikuar:

a) respektimin e limiteve vjetore dhe limiteve totale, që janë përcaktuar rast pas rasti në marrëveshjen e garancisë në skemat e veçanta të garancisë;

b) respektimin e normës së interesit dhe afatit të maturimit, të përcaktuar nga Këshilli i Ministrave;

c) përputhshmërinë e marrëveshjes së huas me kushtet dhe kriteret e marrëveshjes së garancisë, të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Në rastin e konstatimit të mangësive, Agjencia, brenda afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, i kërkon institucionit financiar plotësimin e të metave.

4. Nëse nga verifikimi rezulton se tipat e kontratave të huave janë në përputhje me kriteret dhe kushtet e përcaktuara në marrëveshjen e garancisë, të miratuar nga Këshilli i Ministrave, Agjencia konfirmon këto kontrata dhe bankat vijojnë me procedurat e tyre për kreditimin e huamarrësve, që do të financohen sipas skemave përkatëse të garancisë.

##### Neni 7

#### **Administrimi i informacionit, dokumentacionit të skemave të veçanta të garancisë dhe detyrime të tjera në lidhje me këto skema**

1. Për marrëveshjet e huas të nënshkruara nga institucionet financiare, pjesë e skemave të garancive përkatëse, Agjencia ka detyrë:

a) të mbajë, të arkivojë dhe të përditësojë të dhënat e garancive;

b) të mbledhë dhe të arkivojë të gjithë dokumentacionin dhe raportimet e huadhënësve, dukepërfshirë:

i. kopjet e marrëveshjeve të huas dhe të marrëveshjeve të mirëkuptimit; ii. raportimet e huadhënësve; iii. dokumente të tjera që i konsideron të nevojshme.

c) të rakordojë çdo 3 (tre) muaj të dhënat me huadhënësit dhe ministrinë përgjegjëse për financat;

ç) të raportojë çdo 3 (tre) muaj në ministrinë përgjegjëse për financat për ecurinë e skemave të garancisë.

2. Për skemat e veçanta të garancisë, Agjencia ka detyrë:

a) të monitorojë shlyerjen e detyrimeve të huamarrësve ndaj ministrisë përgjegjëse për financat përpagesat e kryera nga kjo e fundit, në kuadër të marrëveshjeve të garancisë me anë të kontrollit të dokumentacionit dhe me anë të verifikimeve të faturave dhe mandatpagesave të subjekteve;

b) të kryejë mbikëqyrjen e kushteve financiare të të gjithë huamarrësve, që kanë marrë garanci ngaskemat që ajo menaxhon dhe u kërkon huamarrësve informacionin e nevojshëm për realizimin e kësaj mbikëqyrjeje.

3. Të dhënat sipas pikës 1 të këtij neni administrohen në Regjistrin për Kthimin e Garancive Shtetërore. Ky sistem krijohet me vendim të Këshillit të Ministrave sipas përcaktimeve të ligjit në fuqi për bazat e të dhënave shtetërore.

4. Rregullat për bashkëpunimin e Agjencisë me ministrinë përgjegjëse për financat për menaxhimin e skemave të veçanta të garancive, si dhe për mbajtjen e dokumentacionit dhe të të dhënave, sipas këtij neni, përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për financat.

#### KREU IV

#### PAGESA DHE KTHIMI I GARANCIVE SHTETËRORE TË HUAS DHE NËNHUAVE

##### Neni 8

#### **Pagesa sipas skemave të veçanta të garancisë**

1. Agjencia shqyrton kërkesat e huadhënësve për pagesën e garancisë sipas skemave të veçanta të garancisë.

2. Agjencia verifikon brenda 10 (dhjetë) ditëve plotësimin e kushteve për pagesën e garancisë me anë të mandatpagesave të lëshuara nga banka dhe, në rast se janë plotësuar, ia përcjell atë menjëherë ministrit përgjegjës për financat për të proceduar me pagesën brenda afateve kohore të përcaktuara në marrëveshjen e garancisë.

##### Neni 9

#### **Procedura e kthimit të garancisë, huas dhe nënhuas**

1. Me kryerjen e pagesës së garancisë apo skemave të veçanta të garancisë, sipas përcaktimeve në marrëveshjet specifike të garancisë ndaj institucionit huadhënës, sipas legjislacionit në fuqi për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë, ministri përgjegjës për financat njofton Agjencinë për fillimin e procedurave për kthimin e garancisë shtetërore të huas.

2. Në rast se një huamarrës nuk shlyen detyrimet në masën dhe kohën e duhur kundrejt ministrisë përgjegjëse për financat, ministri përgjegjës për financat njofton menjëherë Agjencinë për fillimin e procedurave për kthimin e huas apo nënhuas.

3. Me qëllim kthimin e garancive, huave dhe nënhuas, Agjencia:

a) ndjek shlyerjen e detyrimeve të huamarrësve ndaj ministrisë përgjegjëse për financat për pagesat e kryera nga kjo e fundit në kuadër të marrëveshjeve të garancisë sipas skemave përkatëse të garancisë

dhe marrëveshjeve të lidhura me institucionet financiare, si dhe për detyrimet e pakthyer, që rrjedhin sipas marrëveshjeve të huas apo nënhuas me anë të verifikimit të mandatpagesave;

b) i drejtohet me kërkesë me shkrim institucionit financiar për dorëzimin e dokumentacionit të nevojshëm për realizimin e qëllimit të shkronjës “a” të kësaj pike në rastin e skemave të veçanta të garancive dhe vetëm pasi institucioni financiar ka mbledhur/arkëtuar pjesën e detyrimit të pambuluar nga garancia;

c) kërkon nga shërbimi përbarimor fillimin e procedurave të kthimit të detyrimeve për të cilat ngaministria përgjegjëse për financat, sipas skemës së garancisë, është paguar tërësisht kredia bankare, kundrejt personave fizikë apo juridikë, të cilët kanë detyrime në momentin e kalimit të afatit të maturimit për shlyerjen vullnetare të detyrimit;

ç) kërkon nga organet gjyqësore fillimin e procedurave të falimentimit ose likuidimit kundrejt personave fizikë apo juridikë, të cilët kanë detyrime sipas parashikimeve të ligjit për falimentimin;

d) ka të drejtë të shesë sendet e luajtshme ose të paluajtshme, të kaluara në pronësi të Agjencisë, sipas parashikimeve të ligjit në fuqi për ankandin publik; dh) pas procedurës përbarimore, ka të drejtë të kalojë si kapital të vetë asetet e marra sipas shkronjave “b” dhe “c” të kësaj pike.

4. Nëse kthimi i detyrimeve në marrëveshjen e garancisë është parashikuar të realizohet nga institucioni financiar, kthimi i detyrimeve do të realizohet nga ky i fundit sipas parashikimeve të marrëveshjes specifike të garancisë.

## **Neni 10 Të drejtat e Agjencisë**

1. Me qëllim kthimin e detyrimeve, Agjencia ka të drejtë:

a) të gëzojë të drejtat që institucionet financiare kanë pasur për debitorin, sipas skemave të garancive në bazë të marrëveshjeve me institucionet financiare, në masën e çdo pagese të bërë në kuadër të garancisë së dhënë, si dhe në bazë të marrëveshjes së mirëkuptimit për skemat specifike të garancisë;

b) të marrë në pronësi, me pëlqimin e saj, sendin e lënë ose jo si kolateral, garanci apo dorëzani, kundrejt vlerës së ankandit të fundit të zhvilluar nga përbaruesi gjyqësor në përputhje me nenin 577 të Kodit të Procedurës Civile. Në këtë rast Agjencia zbret nga detyrimi vlerën e sendit sipas shumës së kontabilizuar;

c) të pranojë pagesën nga debitorët ose nga ndonjë person tjetër të të gjithë ose të një pjese të detyrimit për pjesën e detyrimit të paguar (garancisë së paguar) nga ministria përgjegjëse për financat.

2. Procedura e detajuar për kthimin e garancive, huave dhe nënhuave dhe procedurat e marrjes në pronësi të pasurive të lëna si garanci ose jo nga huamarrësit e shitjes së këtyre pasurive të marra sipas shkronjës “b” të pikës 1 të këtij neni përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

## **Neni 11 Identifikimi i pasurive të debitorëve**

1. Për të identifikuar pasuritë e debitorëve, Agjencia kërkon informacion sipas legjislacionit të posaçëm pranë:

a) Agjencisë Shtetërore të Kadastrës;

b) Qendrës së Regjistrimit të Aksioneve;

c) Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor;

ç) institucioneve financiare;

d) institucioneve financiare jobankare; dh) institucioneve të mikrofinancës.

2. Agjencia mund të lidhë marrëveshje bashkëpunimi për shkëmbim informacioni me institucionet sipas pikës 1 të këtij neni.

#### Neni 12

### **Raportimi në regjistrin e kredive të Bankës së Shqipërisë**

1. Agjencia raporton te regjistri i kredive dhe zbaton kriteret e klasifikimit për bankat dhe institucionet financiare jobankare, në mënyrë që këto hua/kredi/detyrime të figurojnë në regjistrin e kredive edhe pasi t'i transferohen Agjencisë, me qëllim që informacioni në regjistrin e kredive për këta huamarrës të jetë i plotë.

2. Mënyra dhe periodiciteti i raportimit sipas pikës 1 të këtij neni, përcaktohen nga Banka e Shqipërisë.

#### Neni 13

### **Përfundimi i garancisë**

1. Garancia shtetërore e huas përfundon kur:

- a) huaja për të cilën është dhënë garancia është shlyer tërësisht nga huamarrësi;
- b) afati i garancisë, siç specifikohet në marrëveshjen e garancisë, ka kaluar;
- c) pagesa i është bërë institucionit huadhënës në përputhje me afatet e garancisë.

2. Agjencia konstaton brenda 10 (dhjetë) ditëve përfundimin e garancisë në rastet e skemave të veçanta të garancisë me anë të verifikimit të mandatpagesave dhe dokumentacionit të Agjencisë dhe njofton menjëherë ministrin përgjegjës për financat.

#### Neni 14

### **Ndalesat**

Agjencia ndalohet t'u kalojë institucioneve financiare bankare ose jobankare të drejtat e saj për mbledhjen e detyrimeve, të cilat janë bërë të kërkueshme dhe që nuk janë ekzekutuar ende nga debitorët, për të cilat është ngarkuar nga ky ligj, përjashtimisht kur parashikohet ndryshe në marrëveshjet specifike të lidhura me institucionet financiare.

#### Neni 15

### **Trajtimi i kredive**

1. Për kreditë, sipas përkufizimeve të shkronjave “dh” dhe “e” të nenit 2 të këtij ligji, e kaluar pranë Agjencisë në bazë të ligjit nr. 8894, datë 14.5.2002, “Për Agjencinë e Trajtimit të Kredive”, të ndryshuar, Agjencia realizon procedurat e kthimit të detyrimeve duke ezauruar rrugët gjyqësore dhe përmbarimore deri në likuidimin total.

2. Për kreditë, sipas përkufizimeve të shkronjave “dh” dhe “e” të nenit 2 të këtij ligji, të cilat janë dhënë nga bankat e nivelit të dytë dhe shoqëria INSIG sh.a., të kaluara pranë Agjencisë pa dokumentacionin ligjor, që vërteton marrjen e kredisë, procesverbal i transferimit të detyrimit kontabël dhe ligjor të këtyre huave përbën titull ekzekutiv dhe zbatohet nga përmbaruesi gjyqësor.

3. Agjencia për përmbaruesin e detyrave të përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni vepron nëpërputhje me parashikimet e këtij ligji.

## **KREU V DISPOZITA TË FUNDIT**

#### Neni 16

## **Dispozita me efekt ndryshues në akte të tjera**

Pas shkronjës “g” të pikës 10 të nenit 4 të ligjit nr. 154/2020 “Për Regjistrin Qendror të Llogarive Bankare” shtohet shkronja “gj” me këtë përmbajtje: “gj) Agjencia për Menaxhimin e Garancive dhe Kredive të Pakthyerat.”.

Neni 17

### **Dispozitë kalimtare**

1. Kreditë, asetet, pasivet dhe kapitali i Agjencisë së Trajtimit të Kredive, të marra prej saj sipas ligjit nr. 8894, datë 14.5.2002, “Për Agjencinë e Trajtimit të Kredive”, të ndryshuar, me hyrjen në fuqi të këtij ligji i kalojnë në pronësi kësaj Agjencie.

2. Personeli i Agjencisë së krijuar sipas ligjit nr. 8894, datë 14.5.2002, “Për Agjencinë e Trajtimit të Kredive”, të ndryshuar, i transferohet Agjencisë.

3. Agjencia vijon të organizohet dhe të funksionojë sipas ligjit nr. 8894, datë 14.5.2002, “Për Agjencinë e Trajtimit të Kredive”, të ndryshuar, deri në ristrukturimin e saj sipas nenit 3 të këtij ligji, i cili përfundon brenda datës 1.1.2024.

4. Ministria përgjegjëse për financat merr masat, sipas legjislacionin në fuqi, për ristrukturimin e Agjencisë dhe përfshirjen e saj në buxhetin e vitit 2024.

Neni 18

### **Aktet nënligjore**

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të nxjerrë aktet nënligjore sipas nenit 3, pika 3; nenit 7, pika 3, dhe nenit 10, pika 2, të këtij ligji.

2. Ngarkohet ministri përgjegjës për financat që brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të nxjerrë aktet nënligjore sipas pikës 4 të nenit 7 të këtij ligji.

3. Deri në hyrjen në fuqi të akteve nënligjore të këtij ligji, vijojnë të zbatohen aktet nënligjore sipas ligjit nr. 8894, datë 14.5.2002, “Për Agjencinë e Trajtimit të Kredive”, të ndryshuar.

Neni 19

### **Shfuqizime**

Ligji nr. 8894, datë 14.5.2002, “Për Agjencinë e Trajtimit të Kredive”, i ndryshuar, shfuqizohet.

Neni 20

### **Hyrja në fuqi**

ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 13.7.2023.

**Shpallur me dekretin nr.160, datë 27.7.2023, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.**